

Shteti zhvillimor

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që modeli ekonomik në Kosovë, përbrenda atij të ekonomisë të tregut, të jetë ai i një shteti zhvillimor. Shteti zhvillimor përpiket që të balancoj rritjen ekonomike me zhvillimin social dhe mirëqenien e përgjithshme. Shteti zhvillimor luan një rol aktiv në drejtimin dhe zhvillimin ekonomik dhe përdorimin e burimeve të vendit për të përmbushur nevojat e qytetarëve të tij. Ky model ekonomik vë në përdorim politikat shtetërore, burimet natyrore dhe ndikimin e shtetit për të luftuar varfërinë, zvogëluar papunësinë dhe pabarazinë, ndërton një klasë të mesme të fortë dhe zgjeron mundësitë ekonomike të Kosovës.

Në gjitha vendet shteti luan një rol kyç në formësimin e strukturës dhe rendimentit ekonomik. Për këtë qëllim përdor një shumëllojshmëri të instrumenteve dhe politikave. Këto politika fillojnë nga rregullimi i industrisë dhe tregtisë, rishpërndarja e të ardhurave dhe pasurive, përdorimi i politikave fiskale dhe monetare e deri tek pronësia e drejtpërdrejtë e shtetit në industri kyçe. Me modelin zhvillimor, shteti nuk është më spektator por bëhet aktor dhe faktor. Ai nuk e kontrollon zhvillimin por merr pjesë në të, nxit orientime të caktuara që dihet se janë të leverdishme, koordinon e mbështet iniciativa të ndryshme, promovon eksportin dhe nxit zëvendësimin e importeve.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për ndërtimin e një shteti zhvillimor që në mënyrë efikase udhëzon zhvillimin ekonomik kombëtar duke mobilizuar burimet e shoqërisë dhe drejtimin e tyre drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta. VETËVENDOSJE! i vendos nevojat e të varfërve dhe çështjet sociale të tilla si kujdesi shëndetësor, strehimi, arsimi dhe rrjeti i sigurisë sociale në krye të axhendës zhvillimore. Prioritete këto pa të cilat zhvillimi ekonomik nuk ka kuptim. Me shtetin zhvillimor tregu është në funksion të ekonomisë dhe ekonomia në funksion mirëqenies së gjithëmbarshme të shoqërisë.

Kosova si shtet zhvillimor do të jetë në gjendje të drejtë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik. Kjo bëhet me ndërtimin e një shërbimi të fortë publik, krijimin e një mjedisi miqësor për investitorët, mbështetjen e zhvillimit dhe rritjen e biznesit të vogël, si dhe duke përdorur ndërmarrjet publike në mënyrë efektive dhe duke kanalizuar iniciativat strategjike investive, iniciativa këto që do ndërtonin industri. Kjo industri sjell zhvillimin, modernizimin dhe punësimin për kundër ekonomisë që bazohet vetëm në shërbime e financa e cila nuk mund të jetë e suksesshme.

Shteti zhvillimor është në gjendje të kontrollojë burimet dhe resurset e mëdha që ka dhe t'i vendos ato përkrah detyrave strategjike zhvillimore të vendit që do të mundësojnë përmbushjen e qëllimeve për një shtet të zhvilluar, të drejtë e social.

Një model i tillë shteti ka nevojë për vullnet dhe guxim politik në mënyrë që të mobilizoj kapacitete strategjike, organizative dhe teknike për të realizuar rolin e tij zhvillimor. Shteti zhvillimor është në gjendje të bashkojë sektorin publik, fuqinë punëtore, universitetin, bizneset dhe shoqërinë civile në ndërveprim deri në mbërritjen e mirëqenies së përgjithshme.

Duke qenë se mbërritja e shtetit zhvillimor thërret kapacitete organizative për të siguruar realizimin e qëllimit, kjo paraqet po kështu dhe gatishmërinë për reforma të domosdoshme që sigurojnë efektivitetin qeverisës. Rrjedhimisht, shteti zhvillimor mbërrin deri tek përmirësimi i sistemit dhe strukturave brenda secilës sferë qeverisëse.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një shtet zhvillimor që është edhe shtet social, shtet universal dhe shtet solidar. Universal sepse të gjithë paguajnë për të mirën e përgjithshme, dhe solidar sepse ata që kanë të ardhura më të larta paguajnë më shumë për të mirën e përgjithshme.



6. Politikat fiskale

Për Lëvizjen VETËVENDOSJE! roli i politikave fiskale përveç gjenerimit të të hyrave të mjaftueshme buxhetore, dhe alokimit të resurseve buxhetore drejt ofrimit të shërbimeve publike ka edhe tre funksione tjera, **mbështetjen e rritjes ekonomike, stabilizimin ekonomik dhe uljen e pabarazisë sociale.**

VETËVENDOSJE! i bazon politikat fiskale në parimet e **drejtësisë dhe barazisë në tatime dhe shpërndarje**, si dhe mendon se politikat fiskale duhet të punojnë drejt arritjes së **stimulimit të prodhimit, investimit dhe krijimit të vendeve të punës**. Gjithashtu politikat fiskale duhet ta bëjnë balancimin e barrës së financimit të buxhetit, në bazë të të mirave që qytetarët përfitojnë nga paratë publike.

Klasa e varfër dhe klasa e mesme financojnë pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës. Shumica e buxhetit të Kosovës financohet nga të hyrat në doganë e që reflektojnë tatime në konsum, ku i gjithë tatimi i bartet konsumatorit përfundimtar. Shumica e konsumit në Kosovë është konsum i mbijetesës, pra, mund të konkludojmë që buxheti i Kosovës financohet nga tatimet mbi klasën e varfër dhe të mesme. Po ashtu, duke marrë parasysh shkallët e tanishme të tatimit në të hyra dhe duke ditur marrë parasysh që shumica e punësimit në

Kosovë është me rrogë mesatare prej rreth 300 Eurosh, konkludojmë që shumicën e tatimeve e paguajnë klasa e mesme e ulët e popullatës.

Por, klasa e varfër dhe klasa e mesme nuk e përfitojnë pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës.

Administrata tatimore **është joprofesionale dhe burim i korrupsionit** e i shkeljeve. Legjislacioni shpesh është i përkthyer e i kopjuar, i papërshtatur me situatën reale.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të orientojë politikat fiskale drejt **mbështetjes së degëve ekonomike që identifikohen si bartëse të zhvillimit ekonomik, rritjes së prodhimit industrial, rritjes së punësimit, dhe përgjithësisht rritjes së mirëqenies.** Ne poashtu do të punojmë drejt gjetjes së modaliteteve të provuara në vende tjera për një adresim më të mirë të programeve të mbrojtjes sociale.

Për të balancuar barrën buxhetore në mes të klasave më të varfra dhe atyre që kanë më shumë mundësi, Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet për të arritur këtë shkallë tatimore për tatimet në të hyra

Për pagat 0-170* euro, tatimi në të ardhura duhet të jetë 0%;
Për pagat 170-500 euro, tatimi në të ardhura duhet të jetë 5%;
Për pagat 500-850 euro, tatimi në të ardhura duhet të jetë 10%;
Për pagat 850-1700 euro, tatimi në të ardhura duhet të jetë 20%;
Kurse për pagat mbi 1700 euro, tatimi në të ardhura duhet të jetë 30%.
**170 euro është paga minimale. Me rritjen e pagës minimale do të ndryshojnë edhe kufijtë e përcaktuar të tatimit progresiv.*
Ndërsa taksa korporative do të ketë margjinat e barabarta me taksën mbi të ardhurat.


Lëvizja VETËVENDOSJE! do të implementojë shkallëzimin e Tatimit në Vlerë të Shtuar në Kosovë në tri nivele. **TVSh do të jetë e përshtatuar për prodhimet ushqimore bazë të jetës në Kosovë, pra për bukë, vaj, kripë, sheqer, qumësht, miell e libra.** Ndërsa produktet që konsiderohen si më luksoze dhe më të panevojshme, do të rriten deri në shkallë prej 20 për qind, në nivel me shumë shtete të Bashkimit Evropian.

Ne do të largojmë TVSh-në në arsim, sepse arsimimi nuk duhet të tatohet, si dhe do të lirojmë të gjitha aktivitetet arsimore me interes për shoqërinë nga Tatimi në Vlerë të Shtuar.

Tatimi në fitim do të rivlerësohet. Kjo politikë tatimore do të përdoret nga VETËVENDOSJE! për të stimuluar hapjen e vendeve të reja të punës. Çdo kompani që dëshmon riinvestimin e fitimit për hapjen e vendeve të reja të punës, sidomos në prodhim, **do të lirohet nga tatimi në profit.**

Tatimi në pronë do të rivlerësohet për të balancuar barrën e tatimit në mes të popullatës sipas të mirave që përfitojnë nga shoqëria si dhe duke marrë parasysh nevojën e Kosovës për të punuar tokat bujqësore. **Si rrjedhim, tokat e papunuara do të taten më lart.** Kjo do të bëhet me qëllim të motivimit për ta punuar tokën.

TATIMET NË TË HYRA



Kosova duhet të fillojë planifikimin dhe negociatat me Republikën e Shqipërisë për adaptimin e valutës së përbashkët të dy shteteve. Kjo do të lehtësonte dhe do të promovonte tregtinë dhe bashkëpunimin në mes të dy shteteve deri te bashkimi kombëtar. Ky planifikim do të nënkuptonte edhe procedurat mbi ndërtimin e përbashkët të politikave monetare kombëtare. Euro ofron një stabilitet të valutës, mirëpo në të njëjtën kohë i pamundëson politikat shtetërore monetare si dhe për shkak të fuqisë që ka vështirëson eksportet kosovare të cilat janë relativisht më të shtrenjta.



7. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural

Më se 60-65% e popullatës së Kosovës jeton në zonat rurale. Në plan-projektin tonë ne i kemi ndarë konceptet e politikave zhvillimore të bujqësisë nga zhvillimi rural, pasi duhet kuptuar që këto janë dy fusha të ndryshme, edhe pse të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Zhvillimi i këtij sektori drejt efijencës dhe efikasitetit, përveçse ndikon dukshëm në rritjen ekonomike dhe rritjen e mirëqenies të një vendi, krijon dhe kushtet për angazhimin e kapaciteteve humane në profesione të tjera, pra hap territorin për urbanizimin e popullsisë dhe të vendit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se Kosova ka nevojë për një strategji qeveritare afatgjatë prej 9 vitesh, e cila ndahet në tri faza të zhvillimit nga 3 vjet. Për secilën fazë të zhvillimit duhet të planifikohen të gjitha hapat që do të ndërmerren duke filluar nga planifikimi i buxhetit; investimet kapitale; subvencionet, grantet;

fondi i dedikuar për zhvillimin e bujqësisë; numri i të punësuarve direkt në sektorin e bujqësisë, në agrobiznes dhe agropërpunim, në sektorin e pylltarisë si dhe në turizmin rural; zëvendësimi i importit me rritjen e prodhimit vendor dhe ngritja e vlerave ekonomike të vendit.

Deri më tani Qeveria e Kosovës ka ndarë një **buxhet shumë të vogël** për bujqësi. Në vitin 2011 buxheti për bujqësi ishte 11 milion euro, në vitin 2012, 21 milionë euro ndërsa në vitin 2013, 23 milion euro. Kostoja e lartë e prodhimit për 1 ha dhe **mungesa e subvencioneve e kredive** të volitshme për bujqësi, ndikojnë negativisht në motivimin e fermerëve për t'i punuar tokat e tyre. Në mungesë të një klime të favorshme kemi edhe **mungesë të investitorëve** të brendshëm dhe të jashtëm në këtë sektor.

Për shkak të strukturës demografike kemi krijimin e **fermave të vogla me më pak se 1 ha** që janë shumë të kushtueshme. Fermerët kosovarë më shumë fokusohen në prodhim pa bërë ndonjë planifikim mbi gjendjen e prodhimit të kulturave bujqësore dhe pa e analizuar trendin e zhvillimit të tregut. Kjo shpesh shkakton **hiperprodhim të një kulture bujqësore dhe mungesë të kulturës tjetër**. Mungesa e bashkëpunimit të fermerëve në planifikimin e mbjelljes së kulturave sipas nevojave të tregut ndikon në rritjen e kostos.

Fermerët po ballafaqohen me vështirësi të mëdha për t'i bërë ballë konkurrencës nga **prodhimet e importura** në tregun vendor. Kjo ndodh meqë prodhimi i importuar ka kosto të ulët të prodhimit sepse është i subvencionuar, kurse inputet (fara, plehu dhe pesticidet) kanë çmim më të volitshëm në vendet prej nga ne importojmë. Po ashtu është shumë vështirë për të plasuar prodhimin tonë jashtë vendit.

Mekanizmi bujqësor është i stërvjetëruar dhe ndikon negativisht në përpunimin e tokës për mbjellje. Nuk ka këshilltarë të mjaftueshëm për fusha të caktuara nëpër drejtori komunale. Meqë leverdia ekonomike në bujqësi, në kushtet e pazhvilluara ku ajo gjendet, është tepër e ulët, apo nuk ka fare leverdi për disa kultura, **sipërfaqet e mbjella që sjellin fitim janë dukshëm duke u zvogëluar**. Njëri nga faktorët për rendiment të ulët është cilësia e dobët e farës

së importuar, apo të prodhuar në Kosovë. **Mungesa e pikave grumbulluese** dhe objekteve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore po ndikon negativisht në situatën e produkteve tona bujqësore nëpër tregje, si dhe në dekurajimin e bujqve për t'u marrë me bujqësi.

Mungesa e fabrikave për përpunimin e produkteve lavërtare, perimore dhe pemëtare dekurajojnë fermerët për të investuar në bujqësi. Zhvillimi i dobët i blegtorisë ndikon direkt në zhvillimin e prodhimtarisë lavërtare e perimore, në mungesë të plehut të stallës (organik). Nuk ka ndonjë **strategji për t'i mbrojtur produktet vendore**. Produktet e huaja hyjnë lehtë në Kosovë pa kontroll të cilësisë.

Politikat për zhvillim

Meqenëse bujqësia edhe punëson edhe prodhon, hartimi i kësaj strategjisë për zhvillimin e bujqësisë sipas Lëvizjes VETËVENDOSJE! duhet të jetë prioritet kombëtar. Një strategji e tillë do të ndikojë edhe në zhvillimin rural. Në **fazën e parë** do të orientohemi drejt zëvendësimit të ngadalshëm të bujqësisë tradicionale me një bujqësi të organizuar, duke i aktivizuar kapacitetet njerëzore në pjesët rurale dhe duke bërë ngritjen e infrastrukturës bujqësore. Në **fazën e dytë** do të orientohemi drejt zhvillimit rural të vendit përmes krijimit të mëtutjeshëm të infrastrukturës bujqësore, zhvillimit të agroturizmit, zhvillimit të industrisë dhe kapaciteteve përpunuese. Në **fazën e tretë** do të zhvillohet bujqësia moderne intensive. Në këtë fazë do të përfundohej krijimi i shumë fermave të mëdha, me aksionerë apo me kooperim fermerësh, të cilat do të huazonin parcelat e vogla dhe, në këtë mënyrë, do të krijoheshin ndërmarrje që kanë kapacitetin e investimit dhe përdorimit të teknologjisë bashkëkohore të prodhimit bujqësor.

Hapi i parë dhe i domosdoshëm që do të ndërmerret është **planifikimi i rritjes së buxhetit** për bujqësi duke filluar që nga faza e parë që do të rritej nga 60 milion në vitin e parë deri në 120 milion euro në vitin e tretë. Ky buxhet në përputhje me zarfin për bujqësi në BE do të ndahej **65%** Subvencione (kultura lavërtare, perimore, pemëtare, vreshtare dhe blegtori), 35% Grante për zhvillim rural (kapacitete

përpunuese, pika grumbullimi, depo). Gjatë kësaj faze po ashtu do ta nisim krijimin e një Fondi të veçantë dedikuar bujqësisë i cili do të ofrojë qasje në kapital për ndërmarrjet bujqësore duke ofruar kredi të buta me grejs periudhë të përshtatshme për investime në intensifikimin e bujqësisë.

Hapi tjetër i rëndësishëm janë investimet në **infrastrukturë për mbështetjen e aktiviteteve bujqësore** e që do të përfshinin, ngritjen e kapaciteteve përpunuese, krijimin e pikave grumbulluese dhe depove për ruajtjen e prodhimeve, zgjerimin e kapaciteteve të serrave, shtimin e fondit blegtoral, shfrytëzimin racional të pyjeve dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të reja, ndalimin e shkatërrimit të shtratit të lumenjve, nxitjen e zhvillimit të turizmit rural (agroturizmit), dhe nxitjen e zhvillimit të bujqësisë organike.

Lëvizja VETËVENDOSJE konsideron se **Orientimi dhe planifikimi i prodhimit** janë veprime të domosdoshme. Kjo duhet të përfshijë orientimin e prodhimit sipas regjionit: lavërtari, perimtar, pemëtar, vreshtari, blegtori, pylltari; planifikimin e prodhimit sipas trendeve të zhvillimit të tregut ; ndërlidhjen e subvencionimit të prodhimit me kontrollin e cilësisë së tyre; nxitjen dhe mbështetjen e fermerëve për krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta bujqësore, mbështetjen e fermerëve për organizimin e tyre në shoqata, dhe ngritjen profesionale të fermerëve.

Bujqësisë i nevojitet rritja e shkallës së sigurisë së investimit dhe prodhimit. Prodhimet vendore do të mbrohen përmes politikave të favorshme fiskale, por veçanërisht përmes kuotave importuese, mbrojtjes sezonale të tregut të prodhimeve, si dhe **ulje të kostos së prodhimit** përmes heqjes së akcizës për naftë dhe prodhimit të inputeve të nevojshme si fara dhe plehu në Kosovë.


Në aspektin afatgjatë, Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se nevojitet **rritja e sipërfaqeve bujqësore** si dhe **zonim i tokave bujqësore ekzistuese**. Tokat duhet të grupohen përmes **komasacionit**. Për shkak të klimës së thatë duhet të punohet në **ndërtimin e sistemit të ujitjes**, dhe krijimin e një **programi nacional për përmirësimin gjenetik të drithërave** që do t'i përshtatej shumë

më shumë kushteve klimatike në Kosovë. Krahas kësaj **prodhimi i plehrave kimike duhet të bëhet brenda vendit** për të siguruar rendimente të larta.

Koncept themelor i planit për bujqësinë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! është edhe **krijimi i një tregu bujqësor tërësisht të integruar midis Kosovës dhe Shqipërisë**. Kjo nënkupton koordinimin e politikave qeverisëse dhe kuadrit ligjor që rregullon këtë sektor, në të dyja vendet. Secila komunë duhet të ndërtojë e të ketë vizionin e vet për bujqësinë dhe zhvillimin rural, bazuar në konsideratat për resurset e veta bujqësore, konfiguracionin gjeografik dhe vizionin e përgjithshëm për bujqësi në Kosovë.

Me qëllim të planifikimit më të mirë, organizimit të shtuar dhe futjes së ekspertizës profesionale drejt rritjes së rendimentit nevojitet **lidhja e prodhuesve bujqësorë me Fakultetin e Bujqësisë dhe Institutin Bujqësor për Hulumtim Shkencor**. Prodhimi bujqësor dhe prodhimi i dijes do ta ndihmonin njëri-tjetrin. Shkollat fillore, spitalet, administrata publike, Qeveri, Kuvendi, pushteti lokal, policia, gjyqësia, burgjet, FSK-ja, KEK-u, PTK-ja, Trepça, RTK-ja dhe ndërmarrjet e institucionet e tjera publike do të pajisen me kuzhinat e tyre (nëse tashmë nuk i kanë) që do të **furnizohen prej produkteve ushqimore bazë nga bujqit vendës**.

RRITJA E BUXHETIT PËR BUJQËSINË





8. Sektori energjetik

Sektori i energjisë ballafaqohet me probleme të shumta organizative, ekonomiko-financiare që kanë për pasojë mospërbushjen e misionit themelor: furnizimin e rregullt me energji për qytetarët e për ndërmarrjet, qëndrueshmërinë ekonomike dhe mbrojtjen e ambientit. **Strategjia e energjisë e vitit 2005-2015 dhe 2009-2018**, me të gjitha mangësitë që janë evidente, **nuk është zbatuar** dhe është ndryshuar për të keq në bazë të kërkesave të këshilltarëve të transaksioneve.

Pasiqë nuk ka strategji të zhvillimit ekonomik, nuk ka as vlerësim të nevojave për energji, sasinë e kapaciteteve të reja energjetike, madhësinë dhe numrin e njësive të gjenerimit. Rrjedhimisht vendimet politike për sa i përket gjenerimit kanë qenë parciale dhe përherë të ndryshueshme: nga 2100 MW, në 1000 MW dhe tani në 2x300 MW. Kanë kaluar tetë vite dhe janë shpenzuar mjete marramendëse nga Buxheti i Kosovës dhe tani gjendemi në pikën fillestare sa i përket ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese.

Efiçienca e Energjisë (EE) asnjëherë nuk është trajtuar dhe nuk po trajtohet si potencial me prioritet të zbatimit nëpër sektorët e ekonomisë. **Nuk është themeluar Korporata e Thëngjillit**, dhe kështu aset i më i rëndësishëm shkon në pako me “Kosovën e Re”.

Në tetor të vitit 2012 Qeveria e Kosovës bëri shitjen e kompanisë kosovare të distribucionit dhe furnizimit me energji elektrike (KKDFE) **për vetëm 26.3 milionë euro**. Vendimet janë marrë në mungesë të plotë të transparencës, prej komitetit ndërministror. Me zbatimin e "partneritetit publiko-privat" Qeveria është bartëse e rrezikut në tërësi, ndërsa kompania private është vetëm bartëse e profitit.

Politikat për energji

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për zhvillimin e sektorit të energjisë në funksion të **rritjes së qëndrueshme ekonomike të Kosovës dhe të mirëqenies së qytetarëve**. Ky zhvillim do të sigurojë shfrytëzimin racional të resurseve energjetike, dhe ofrimin e shërbimeve energjetike të cilësisë së lartë dhe me kosto të ulët, rritjen dhe zbatimin e programeve të eficiencës dhe sigurisë së furnizimit, duke marrë parasysh kujdesin për mjedisin. Ngritja e kapaciteteve gjeneruese në bazë të linjitet, duhet të shoqërohet me ndërtimin e shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtërishe.

Investimet prioritare do të bëhen sipas parimit të rritjes së sigurisë së sistemit dhe zvogëlimin e humbjeve teknike e komerciale. Për çështje me rëndësi për funksionimin dhe zhvillimin e sektorit do të organizohen **diskutime publike**, kurse për ato fundamentale edhe **referendum**.

Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se duhet të **zgjerohet programi i fakulteteve teknike** të Universitetit të Prishtinës me lëndë të reja. Po ashtu do të themelohen qendra-laboratorë hulumtues pranë Korporatës së Thëngjillit, të gjenerimit, distribucionit dhe KOSTT. Laboratorët dhe Fakultetet Teknike do të zhvillojnë bashkëpunim për përgatitjen dhe ngritjen e kuadrit profesional për realizimin e projekteve të përbashkëta.

VETËVENDOSJE! do të përgatisë **program gjithëpërfshirës** për sanimin e pasojave të ndotjes historike. Me Ligjin për Miniera dhe Minerale, duke konsultuar praktikant më të mira prej vendeve të zhvilluara, do të vendoset edhe **taksa për mbylljen e minierave pas përfundimit të shfrytëzimit**. Ngrohja prej kogjenerimit do ta

zvogëlojë ndotjen e ambientit sepse ngrohtoret lokale dhe ngrohjet individuale me djegie fosile janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit në muajt e dimrit. Termocentrali i ri do të ndërtohet me teknologjinë më të mirë në dispozicion e cila do të mundësojë zvogëlimin e konsumit të thëngjillit për 30-45% për çdo njësi energjie të prodhuar, krahasuar me shpenzimin aktual në KEK. Po ashtu do të shikohet mundësia e rigjenerimit të plotë të Kosovës A duke instaluar aty teknologjinë më të re të djegies nëntokësore të thëngjillit. Projektet e tilla do të bashkëfinancohen nga paratë publike të Republikës së Kosovës, kredive afatgjate nga prodhuesit e teknologjisë dhe fondet e BE-së për mjedis.

Energjia elektrike në Kosovë sot **shfrytëzohet në mënyrë tejet joracionale**, në masë të madhe për nevoja termike. Do të investohet në projektet e sigurimit të nxehjes prej procesit të kogjenerimit. Do të stimulohet shfrytëzimi i energjisë solare, energjisë gjeotermale dhe gazit teknik për nxehje dhe furnizim me ujë të nxehtë në zonat që nuk përfshihen me nxehje qendrore.

Duhet të bëhen përgatitjet e nevojshme për **kyçje të Kosovës në gazin natyral**. Komiteti për energji i BE-së gjithashtu ka përgatitur studimin për gazifikimin e shteteve të Evropës juglindore dhe krijimin e unazës së gazit. Në këtë studim është vlerësuar se kyçja e Kosovës në unazë është e realizueshme.

Do të **rithemelohet Korporata e Linjtit**, në pronësi publike, në kuadër të së cilës do të përfshihen minierat ekzistuese, fushat e shfrytëzimit dhe zonat hulumtuese të linjtit. Korporata do të menaxhohet në funksion të shfrytëzimit racional të linjtit, mbrojtjen e ambientit, zhvillimit të sektorit të energjisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror-ekonomik të Kosovës.

Do të **ndërtohen dy agregatë gjenerues në pronë publike**, me kapacitet identik me Kosova B1 dhe B2. Kapacitetet e reja gjeneruese do të ngrihen pranë kapaciteteve ekzistuese, e me këtë do të shfrytëzohen racionalisht infrastruktura ekzistuese në atë hapësirë. Termocentrali i ri do të ndërtohet me teknologji më të mirë e cila do të mundësojë shfrytëzimin racional të thëngjillit dhe mbrojtjen

e ambientit. Konform standardeve dhe praktikave bashkëkohore të ndërtimit të kapaciteteve të reja, bashkëgjenerimi për prodhimin e energjisë termike do të jetë pjesë e pandashme e sistemit krahas prodhimit të energjisë elektrike.

Investimi i parashë publikë në këto kapacitete është në dobi të sigurt për secilin qytetar të Kosovës sepse sjell furnizim stabil me energji elektrike me çmime të ulëta. Çmimi i energjisë elektrike nga Kosova e re e ndërtuar me kapital privat, sipas Ekspertëve të BB do të kushtojë 81,42€/Mwh, kurse me humbjet në rrjet 106€/Mwh. Ky çmim është i papërbalueshëm për ekonomin dhe konsumatorët familjarë. Në vitin 2011 pragu i çmimit në Kosova A dhe B ka qenë 24.4€/MWh.

Kosova do të kryejë hulumtime të nevojshme dhe do të përgatitë program gjithëpërfshirës për **zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtërishe**. Mbështetur në rregullat e BE-së dhe dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova me masa ligjore do të stimulojë angazhimin e kapitalit privat në ngritjen e kapaciteteve të BRE dhe programeve të Efiçencës së Energjisë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është **kategorikisht kundër privatizimit të Distribucionit**. Distribucioni dhe furnizimi me energji elektrike, ku përfshihet rrjeti por edhe tregu i saj, janë pasuri publike e Kosovës. Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë është monopol natyror. Monopoli privat në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i mirë për ekonominë e as për qytetarët, për shkak se kontrolli i tij përmbi sektorin e energjisë bëhet absolut. Energjia dhe infrastruktura e shpërndarjes së saj është çështje sovraniteti. Distribucioni nuk është vetëm infrastrukturë, por është edhe organizatë. Duke qenë se qëllimi i kompanisë private është thjesht maksimizimi i fitimit, shtrenjtimi i energjisë elektrike si dhe reduktimi i vendeve të punës në këtë kompani do të bëhen të pashmangshme.

Largpërçuesi 400 kV dhe sistemi për monitorimin dhe menaxhimin e energjisë krijojnë kushte të plota teknike për **organizimin dhe funksionimin e sistemit unik elektro-energjetik Kosovë-Shqipëri**. Duhet të intensifikohen punët në përgatitjen dhe nënshkrimin e

marrëveshjes për formimin e sistemit të përbashkët energjetik. Në këtë fazë duhet përgatitur bilanci i përbashkët elektro-energjetik dhe projeksioni i zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë.

Kosova tani disponon me kapacitet termo për prodhimin e energjisë elektrike prej 880 MW kurse Shqipëria kapacitet prodhues 1450 MW nga hidro-energji. **Menaxhimi i përbashkët i këtyre kapaciteteve prodhuese do t'i zvogëlonte dukshëm problemet e tanishme në furnizim.** Shqipëria ka hidropotenciale të mëdha. Tani shfrytëzohen vetëm 30% për prodhimin e energjisë elektrike. Kurse Kosova posedon rezerva shumë të mëdha të linjitit, të tretat në Evropë, për prodhim të energjisë me çmim konkurrues në tregun botëror. Potencialet e përbashkëta mundësojnë që Shqipëria dhe Kosova të bëhen superfuqi energjetike jo vetëm në regjion. Krijimi i sistemit të përbashkët energjetik është në frymën e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe në përputhje me politikat e BE-së.



9. Zhvillimi i industrisë minerare

Investimet në industrinë e Kosovës kanë nisur pas vitit 1968, e sidomos pas aprovimit të amendamenteve të Kushtetutës së Kosovës të vitit 1972 deri në fillimin e viteve të 80-a. Kjo ishte koha e krijimit të kapaciteteve industriale të Kosovës, të cilat pjesërisht vijuan të jenë funksionale deri më sot – kur po bien pre e privatizimit të egër të qeverive të pasluftës. Në vitin 1988 industria në krijimin e produktit shoqëror merr pjesë me 41.6% kurse bujqësia (industria e lehtë), me fabrika të shumta për përpunimin e produkteve ushqimore, me 27.8%.

Në periudhën 1989 – 1999, kur represioni mori përmasa brutale, ekonomia e Kosovës pësoi degradim të rëndë. Prej punës u përjashtuan 145.000 punëtorë dhe ekspertë shqiptarë, edhe pse kapacitetet industriale vazhduan të shfrytëzohen, kryesisht prej 40 deri në 50% të tyre.

Deindustrializimi dhe privatizimi i egër neoliberal u shndërrua në ideologji të qeverive të pasluftës, gjë që çoi në shkatërrimin e ekonomisë dhe të pjesës më të madhe të industrisë e prodhimit.

Privatizimi nuk e ndaloj korrupsionin, përkundrazi shumë tendera dhe kontrata u lidhën në mënyrë të paligjshme, të parregullt ose korruptive, dhe një pjesë e mirë e ndërmarrjeve e ndryshuan destinacionin dhe profilin, duke mos qenë më pjesë e prodhimit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një shtet me rol koordinues, **sipas konceptit ekonomik modern të quajtur Shtet Zhvillimor.** Lëvizja VETËVENDOSJE! vlerëson se prioritet për zhvillimin industrial dhe ekonomik do të kenë sektorët që mbështeten në resurset dhe potencialet ekonomike vendëse, si dhe në eksperiencën e krijuar profesionale: zhvillimin e xehetarisë, sidomos asaj me ngjyra, metalurgjisë dhe prodhimin e produkteve finale të tyre, përpunimin industrial të linjitit në produkte dhe teknologji të kohës dhe ngritjen e kapaciteteve përpunuese të agrobiznesit.

Trepça ka traditë dhe eksperiencë për hulumtimin, eksplotimin dhe përpunimin e xeheve të plumbit zinkut, argjendit, arit etj. Pas përfundimit të luftës, me ndarjen e Kosovës ndahet edhe Trepça e cila prej UNMIK-ut vlerësohet si grumbull problemesh politike, ekonomike, ambientale dhe sociale, dhe nuk lejohet të regjistrohet si ndërmarrje biznesi, por vendoset nën administrim të UNMIK-ut e pastaj të AKM-së dhe AKP-së. Borxhet e supozuara janë krijuar pasi që Kuvendi i Republikës së Serbisë vendosi masa të përkohshme në Trepçë, prandaj edhe borxhet eventuale duhet t'i bartë Serbia.

Trepça tani është në administrim të AKP-së, sipas Ligjit Nr. 04/L-35 për riorganizimin dhe likuidim. Administratori ka përgjegjësi dhe autoritet të plotë për të ndërmarrë të gjitha veprimet për të menaxhuar veprimtarinë, afarizmin dhe pronën e Trepçës, kurse AKP-ja nuk ka strukturë e as ekspertë për menaxhim. Administratori ka imunitet të plotë dhe nuk përgjigjet për dëmet që i shkaktohen Trepçës. Këshilli i kreditorëve, i cili me Ligj parashihet të jetë i përbërë nga të gjitha kompanitë që pranohen nga gjykata të jenë kreditore a pronarë të pjesshëm të Trepçës, është vendimtar në propozimin por edhe zgjidhjen e Planit për riorganizimin e Trepçës.

Minierat, metalurgjitë dhe industria kimike në bazë të gazrave metalurgjike duhet të **organizohen në ndërmarrje publike**. Potenciali kryesor i Trepçës janë **resurset minerale që vlerësohen mbi 50 mil/t**. Brezi metalogjenik i Trepçës shtrihet në një **gjatësi prej 80 km**, dhe përbëhet prej një numri të madh vendburimesh dhe mineralizimeve tjera përcjellëse. Në këtë hapësirë shtrihen dhjetëra miniera të plumbit dhe zinkut të cilat me investime të vogla mund të riaktivizohen ose modernizohen

Detyrë primare është vazhdimi i hulumtimit në brezin mineral të Trepçës, si dhe zgjerimi i kapaciteteve prodhuese, aplikimi i teknologjive dhe pajisjeve bashkëkohore në minierat ekzistuese. Gjatë mandatit të Lëvizjes VETËVENDOSJE!-s do të bëhet rehabilitimi dhe ristartimi i kapaciteteve ekzistuese për prodhimin e 50.000 ton zink elektrolit në vit. Po ashtu angazhohemi për ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhim të 60.000 ton Pb. Shteti me pako të ligjeve do të stimulojë investimet në kapacitete përpunuese dhe do të garantojë furnizim të sigurt me metale për këto kapacitete, nën kushtet e tregut.



10. Telekomunikacioni dhe komunikimet elektronike

Duke marrë parasysh gjendjen e tanishme në sektorin e telekomunikacionit dhe kushtet e veçanta të vendit, VETËVENDOSJE zotohet për vendosjen e **sistemit unik kombëtar të telekomunikacionit**, vendosjen e **mbikëqyrjes publike dhe konsolidimin e operatorit publik**, dhe vënien e **rregullit në shfrytëzimin e burimeve të shterrshme**. Për më shumë VETËVENDOSJE zotohet për krijimin e Bazës Ligjore dhe strukturës institucionale të qeverisjes me sektorin e komunikimeve elektronike.

Në një afat sa më të shkurtër do të përgatitet një pasqyrë e të gjithë ofruesve, të çfarëdo lloji, të shërbimeve telekomunikuese publike, përfshirë sjelljen në vend të trafikut IP, dhe do të konstatohet baza ligjore e pranisë së tyre në treg. Ofruesit që konstatohet se janë të pranishëm ilegalisht në treg, do t'u urdhërohet të **ndërpresin punën menjëherë** dhe do t'u faturohen të gjitha detyrimet eventuale ndaj shtetit që nga fillimi i veprimit të tyre ilegal në treg.

Të gjitha operacioneve tjera do t'u kërkohej përditësimi i dokumentacionit. Shfrytëzuesve ilegalë do t'u merren frekuencat e të tjerëve do t'u kërkohej përditësimi i dokumentacionit dhe dëshmia se frekuencat i përdorin në pajtim me dokumentacionin që kanë. Në të dyja rastet do të kërkohej shlyerja e detyrimeve shoqërore që u takojnë.

Do të konstatohej gjendja ekzistuese e mbulimit të territorit të Republikës nga ana e operatorëve të vendeve fqinje dhe **do t'u kërkohej të bëjnë korrigjimet e nevojshme në pajtim me rregullat ndërkombëtare**. Kjo çështje do të jetë një nga temat në kontaktet me autoritetet qeveritare të vendeve fqinje derisa të zgjidhet.

Në territorin e Republikës së Kosovës do të përdoret vetëm një kod ndërkombëtar dhe një **sistem unik i numeracionit**. Kodi ndërkombëtar do të sigurohet përmes anëtarësimit në ITU, e nëse kjo do të kërkojë kohë më të gjatë, zgjidhja do të gjendet në ndarjen e kodit gjeografik të Republikës së Shqipërisë ose kodit të BE-së. PTK do të jetë i vetmi operator që ofron kapacitete për lidhje ndërkombëtare.

Me qëllim të vendosjes së mbikëqyrjes publike dhe të konsolidimit të PTK-së, do të ndërmerren masa për konsolidimin e shpejtë të PTK-së, që përfshijnë uljen e shpenzimeve, përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e vlerës së kësaj pasurie të çmueshme publike. **Do të emërohet një ekip profesional menaxhues** dhe një ekip profesional mbikëqyrës për një afat prej dy vjetësh me detyrë realizimin e këtyre objektivave.

Me qëllim të vënies së rregullit në shfrytëzimin e burimeve të shtershme do të hartohet **Plani kombëtar i frekuencave** bashkë me rregulloret përcjellëse për ndarjen, licencimin, kontrollin dhe monitorimin e spektrit frekuencor, përfshirë edhe koston e spektrit të dhënë në shfrytëzim.

VETËVENDOSJE është **kundër privatizimit të PTK-së**. Me privatizimin e Telekomit të Kosovës, buxheti i Kosovës humb potencialisht dhjetëra milionë euro të hyra në vit. Telekomit i

Kosovës është një aset strategjik që i përket vendit tonë dhe si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë të sigurisë. Privatizimi i PTK-së e konverton një monopol publik në atë privat. Ky konvertim, për më tepër, po bëhet nëpërmjet një procesi të shoqëruar nga paaftësia, mungesa e transparencës, pikëpyetje të mëdha rreth financimit dhe origjinës së kompanive, si dhe dyshimet për korrupsion. Gjatë gjithë këtij procesi, Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë vendimmarrës në Republikën e Kosovës është mbajtur jashtë vendimmarrjes.

Lëvizja VETËVENDOSJE zotohet për **mbulimin e çdo cepi të vendit** me të gjitha llojet e shërbimeve komunikuese bashkëkohore që i kërkon ekonomia dhe qytetarët e vendit, të një cilësie të pranueshëm e me çmim të përballueshëm për të gjithë. Komunikimet elektronike duhet të jenë në pajtim me kërkesat e sigurisë personale, publike e kombëtare. Duhet t'i jepet shtytje krijimit të përmbajtjeve vendore në internet.

Do të hartohet një **plan veprimi i detajuar** dhe do të përcaktohen përgjegjësit për realizimin e detyrave të përcaktuara në plan. Do të përgatitet **ligji gjithëpërfshirës për komunikimet elektronike** i cili do të mundësojë realizimin e kësaj politike. Do të përgatitet një **program gjithëpërfshirës për aftësimin e personelit** në fushat kyçe të politikëbërjes dhe të rregullimit të sektorit të komunikimeve elektronike dhe zbatimi i këtij programi në institucioneve më të përshtatshme botërore.





11. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sektori privat

Duke kuptuar që sektori privat është një nga punëdhënësit kryesorë, Lëvizja VETËVENDOSJE! e ka të qartë që shteti duhet të luajë një rol aktiv për krijimin e politikave që inkurajojnë ndërmarrësinë, stimulojnë segmente të caktuara të sektorit privat të rëndësishëm për strukturën ekonomike, por edhe shpërblen krijimin e vendeve të punës.

Ne e kuptojmë rëndësinë dhe rolin e sektorit privat dhe bizneseve të vogla dhe të mesme në qëndrueshmërinë dhe strukturën ekonomike të Kosovës. **Ekonomia e tregut** është bazamenti ekonomik mbi të cilin do ndërtohet modeli zhvillimor ekonomik i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, por në të njëjtën kohë duhet balancuar **prioritetet e dyfishta të rritjes së sektorit privat dhe zhvillimit të barabartë social**. Rritja e sektorit privat është një mjet për avancimin shoqëror dhe ekonomik, vetëm atëherë kur sjell përfitime për të gjithë shoqërinë, e jo vetëm të ardhura për biznesin e veçantë.

Mbi **95% e bizneseve në Kosovë janë të vogla**, pra me më pak se 4 punëtorë dhe kryesisht janë në pronësi individuale ose familjare, pra janë mikrobiznese ku pjesa dërrmuese e tyre janë të orientuara në tregti dhe shërbime. Qëllimi ynë është që ta kthejmë besimin që NVM mund të rriten, të ndihmojë aktivisht rritjen e sektorit privat e cila do zbërthehej në më shumë vende të denja të punës dhe standarde më të mira të jetës.

Synimi ynë është që të vendosim një bashkëpunim më të ngushtë në mes të institucioneve të shtetit dhe sektorit privat. VETËVENDOSJE! beson se roli i shtetit në krijimin e ambientit i cili mundëson rritje të NVM-ve dhe ku sundon rendi dhe ligji është fundamental.



Në këtë drejtim VETËVENDOSJE do të ndërmerr masa drejt krijimit të mekanizmave të cilat bëjnë financimin e NVM-ve më të lehtë dhe më të lirë. Disa prej këtyre mekanizmave janë: **skema garantuese për NVM, Fonde Investive për NVM, subvencionim të kamatave për NVM** që janë të integruara në zinxhir të vlerës të sektorëve strategjikë etj.

Politikat tatimore do të riformulohen në favor të rritjes së NVM-ve drejt prodhimit dhe punësimit. Administrata shtetërore do të transformohet për t'i shërbyer NVM-ve në mënyrë që të sigurohet që evazoni fiskal të mos bartet tek ndëshkimet tatimore për NVM,

që lejet dhe taksat komunale dhe qendrore të jenë të unifikuara, dhe që shërbimet të cilat jepen nga administrata të jenë në funksion të zhvillimit.

VETËVENDOSJE! e ka të qartë që NVM-të mund të përjashtohen nga çdo proces i shitjes tek sektori publik për arsye specifike. Rrjedhimisht, do të kërkohet **ndryshimi i ligjit të prokurimit në mënyrë që së pari të promovohen shërbimet/produktet vendore**, e për më shumë, që ato që mund të prokurohen nga NVM të mos prokurohen nga ndërmarrjet e mëdha (vendore ose ndërkombëtare), duke krijuar potencialitet të rritjes për këto ndërmarrje.



12. Arsimi dhe shkenca

E drejta për arsim është e drejtë universale dhe e patjetërsueshme njerëzore dhe shteti ka për obligim t'ua sigurojë të gjithë qytetarëve mundësinë për t'u arsimuar dhe shkollim cilësor. Arsimi publik në të gjitha nivelet **duhet të jetë falas** dhe të plotësojë nevojat e nxënësve dhe studentëve. Sistemi arsimor publik duhet të mbështetet në parimin e solidaritetit shoqëror. Të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim gjinie, etnie, religjioni apo gjendje sociale duhet të kenë **qasje të barabartë në arsim cilësor**, në mënyrë që të arrihet potenciali i plotë shoqëror.

Lëvizja VETËVENDOSJE! e sheh arsimin si **mënyrë për zhvillimin e burimeve njerëzore, të cilat pastaj kontribuojnë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror**. Lëvizja VETËVENDOSJE! beson se njeriu duhet të mësojë gjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, institucionet shkollore duhet t'u shërbejnë jo vetëm grupmoshave të caktuara të fëmijëve dhe adoleshentëve, por edhe atyre bashkëqytetarëve, të cilët për arsye të ndryshme, nuk e kanë mbaruar një pjesë të shkollimit në kohën kur është pritur prej tyre.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do t'i iniciojë ndryshimet e nevojshme në legjislacion që **shkolla dhe komuniteti i saj ta bartin përgjegjësinë**

për funksionimin e institucionit. Një prej këtyre iniciativave do të jetë që drejtori i shkollës duhet të emërohet nga Këshilli i Shkollës, ndërsa personeli tjetër nga drejtori. Duhet shtuar numri i inspektorëve të arsimit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të insistojë që **sistemi i arsimit në Kosovë të jetë unik** për të gjithë, pra dhe për minoritetet, duke pasur në vëmendje veçantitë e sidomos mësimin e gjuhëve, specifika të cilat nuk duhet të nxisin urrejtje ndëretnike siç ndodh aktualisht me ndërhyrjen ilegale dhe të qëllimshme të institucioneve të Serbisë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se shkollat duhet **të mbahen përgjegjëse për suksesin që tregojnë fëmijët**, prandaj, në rast të rezultateve jo të kënaqshme në testet shtetërore, duhet shqyrtuar masat e përgjegjësishë ndaj drejtuesve dhe mësimdhënësve.

Është e domosdoshme që politikat e arsimit të zhvillohen në bazë të të dhënave konkrete me informata (mbi performancën në teste shtetërore, shkollimin e prindërve, gjendjen socio-ekonomike) për secilin nxënës në secilën shkollë që mund të arrihet përmes zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të informatave të arsimit. Shteti do të ketë informata bazë për secilën shkollë, komunë, rajon, të cilat mund të shfrytëzohen për të bërë ndarjen e granteve shkollore sipas nevojës dhe në mënyrë të drejtë. Vetëm atëherë kur kemi pasqyrë të qartë mbi situatën në shkolla, mund të krijojmë politika të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë të Kosovës.

Sistemi parashkollor

Edukimi parashkollor në Kosovë karakterizohet me një përfshirje jashtëzakonisht të ulët të fëmijëve të moshës deri në 5 vjet, e cila nuk kalon 3.5%. Hapi i parë për përmirësimin e gjendjes është hapja e paraleleve parafillore në të gjitha shkollat e Kosovës, duke liruar kështu një pjesë të kapaciteteve në institucionet parashkollore të specializuara për fëmijët e moshës 5-6 vjeç.

Arsimi fillor dhe i mesëm

Kosova ka një rrjet prej 614 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, ku mësojnë 295,218 nxënës. Ndërkaq, në 94 shkolla të mesme të larta mësimin e vijojnë 106,829 nxënës. Infrastruktura shkollore është akoma në gjendje jo të mirë dhe një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore nuk ofrojnë mjedis të shëndetshëm për nxënësit.

Profilët brenda arsimit profesional në shumë raste, nuk janë aspak tërheqëse për nxënësit për faktin se nuk mundësojnë punësim e as vazhdim të shkollimit. Në komunat e vogla, nxënësit janë të diskriminuar, pasi kanë mundësi më se të kufizuara për zgjedhjen e drejtimit të dëshiruar të shkollimit.

Në përgjithësi, shkollat në Kosovë nuk janë të pajisura me mjete didaktike, ndërsa teknologjia informative është në dispozicion vetëm në një numër të kufizuar shkollash. Siguria paraqet problem në mjediset urbane, veçanërisht në shkollat e mesme të larta.

Lëvizja VETËVENDOSJE! zotohet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme. Numri i fëmijëve për secilën klasë duhet të jetë jo më i lartë se 25. Do të hartohet një plan për sigurimin e pajisjeve të nevojshme didaktike për të gjitha shkollat dhe, gradualisht, **do të bëhet pajisja e tyre me teknologji informative.**

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë duhet të jenë sa më afër fëmijëve, ndërsa shkollat shumë të vogla me paralele të kombinuara duhet të mbyllen sa herë që ekziston mundësia e transportit të nxënësve në ndonjë shkollë të afërt me kushte optimale për punë. Rrjeti i shkollave të mesme të larta duhet të riorganizohet në tërësi. Numri i nxënësve të regjistruar në gjimnaze dhe në shkolla profesionale duhet të jetë afërsisht i njëjtë, ndërkaq profilet arsimore në shkolla profesionale duhet të rishikohen çdo vit, që të sigurohet punësueshmëria e të diplomuarve.

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të përkujdeset që në nivelin qendror dhe në nivele komunale të hartohet legjislatiioni sekondar dhe rregulloret

që sigurojnë **respektimin e kodit të mirësjelljes në shkolla**, duke zbatuar edhe masa ndëshkuese ndaj atyre që bëjnë shkelje

Të gjitha objektet e reja shkollore në Kosovë do të ndërtohen duke pasur në konsiderim nevojën për të siguruar qasje **të papenguar për personat me nevoja të veçanta**. Puna me fëmijët me mundësi të kufizuara do të koordinohet nga qendrat regjionale burimore që tanimë ekzistojnë.

Në mandatin e dytë qeverisës, Lëvizja VETËVENDOSJE! synon që ta përpilojë dhe nis realizimin e programit i cili do ta eliminonte **notimin diferencial në katër vitet e para** të shkollimit fillor. Nga të gjitha shkollat do të kërkohet të organizojnë orë shtesë për nxënësit që tregojnë prirje të veçantë për disiplina të caktuara.

Republika e Kosovës duhet ta njohë institucionalisht punën madhështore dhe të palodhshme të mësimit në mënyrë që të pamohueshme i ka kontribuar lirisë dhe zhvillimit tonë.

Kurset të cilat mësimit në mënyrë të ofrojnë jashtë orarit të mësimit dëmtojnë procesin e arsimit publik rrezikojnë krijimin e favorizimit (kryesisht ndaj atyre që janë në pozitë më të favorshme për të paguar kurset) dhe e zhvendosin procesin mësuesor prej klasës.

Do të angazhohen studentët më të mirë të programeve master dhe doktoraturë në mësimit nëpër shkollat e mesme në këmbim të bursave që do të marrin si studentë të shkëlqyer. Kjo do ta rrisë cilësinë e mësimit në shkollat e mesme. **Do të ndërmerret një fushatë vetëdijësuese mbarëkombëtare për rëndësinë e të lexuarit, me përqendrim në shkollat fillore dhe të mesme.** është e domosdoshme **futja e lëndës së Mendimit Kritik në shkollat e mesme, si dhe futja e logjikës gjuhësore dhe matematike si lëndë në shkollat fillore**

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të **sigurojë një shujtë ushqim** për të gjithë nxënësit në shkollat fillore. Poashtu do të sigurohet **një kontroll mjekësor për të gjithë nxënësit e shkollave fillore e të mesme një herë në muaj**. Shkolla do të kthehet në qendër komunitare, pas

orarit të mësimi. Ajo do të shërbejë për aktivitete kulturore e sportive, ku do të marrin pjesë edhe anëtarë të tjerë të komunitetit, prindër etj.

Barazia në rezultate do të arrihet përmes mësimi shtesë, i cili do të jetë zëvendësim për kurset aktuale private që ofrojnë mësimdhënësit. Për mësimin shtesë përgjegjëse do të jetë shkolla dhe kolegji i mësimdhënësve, dhe nevoja për të do të vlerësohet kolektivisht. Mësimdhënësit që angazhohen për mësim shtesë do të kenë pagesë shtesë për këtë angazhim.

Arsimi i lartë

Ka vite që Universiteti i Prishtinës është shndërruar në poligon për realizimin e ambicieve të papërbushura akademike të koniukturës aktuale politike, e cila nuk zgjedhë rrugë për t'i akomoduar në universitet eksponentët e vet, e po ashtu edhe qasja në poste në universitete publike në bazë të trashëgimisë. Hapja e pesë universiteteve të reja publike në Prizren, Pejë, Gjilan, Gjakovë e Mitrovicë pa ndonjë analizë të mirëfilltë të fizibilitetit dhe pa vendimin e Kuvendit të Kosovës, si dhe premtimet për hapje të universiteteve publike në qytetet të tjera janë forma të tjera të keqpërdorimit të arsimit të lartë për qëllime politike. Institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë pagesa për semestër, të cilat janë krejtësisht të paarsyeshme,.

Sektori privat i arsimit të lartë ka pësuar një zhvillim të hovshëm në 10 vitet e fundit dhe i shërben mbi 20% të studentëve në Kosovë. Megjithatë, numri më i madh i institucioneve private nuk kanë kuadër akademik të përhershëm, ndërsa kriteret për fitimin e thirrjeve akademike nuk janë të njëjta me sektorin publik. Këto institucione më shumë funksionojnë si biznese sesa si institucione arsimore.

Institucioneve publike të arsimit të lartë **do t'iu kthehet fuqia vendimmarrëse,** duke i bërë ndryshimet e nevojshme në ligj dhe duke sugjeruar frymën e këtyre ndryshimeve edhe në statutet e tyre me të cilat suprimohen organet që bëjnë të mundur ushtrimin e ndikimit politik nga Qeveria.

Në institucionet publike do të **hiqen tarifat për pagesën e semestrit**, ndërsa do të lejohen tarifa vetëm për shërbime të veçanta, e që duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me kushtet ekonomike të qytetarëve të vendit. Për shkak të interesimit të shtuar të të rinjve për studime, do të stimulohet hapja e programeve të studimeve me orientim profesional. Kjo do të shoqërohet me rritjen e stafit akademik dhe ambienteve universitare.

Do të krijohen fonde të veçanta që do të shërbejnë për të stimuluar studentët të orientohen në degë të rëndësishme strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, me fokus të veçantë në shkencat ekzakte, **bujqësi, inxhinieri dhe mjekësi**. Me qëllim të sigurimit të cilësisë, Agjencia e Akreditimit e Kosovës do të vihet në varësi të drejtpërdrejtë të Kuvendit të Kosovës që do të mundësojë funksionimin e saj si institucion i pavarur. Procesi i akreditimit duhet të jetë garanci se institucioni, respektivisht programi përkatës i arsimit të lartë, ofron cilësinë e duhur.


SHPENZIMET FAMILJARE

1%
ARSIM

38%
USHQIM

31%
BANIM

31%
RRYMË, UJË,
TELEFONI



Do të krijohet një fond i veçantë për mobilitetin e kuadrit akademik nga universitetet e Shqipërisë dhe vendeve të rajonit të nevojshëm për realizimin e programeve mësimore në institucionet publike të Kosovës. Kthimi i studentëve më të mirë të diplomuar në universitet është i domosdoshëm. Kjo do të bëhet me qëllim që në sistemin arsimorë të universitetit, përkatësisht në procesin e mësimdhënies aty, të angazhohen dhe të kontribuojnë të diplomuarit e shquar në universitet.

Puna kërkimore dhe shkencore

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të insistojë në zbatimin e plotë të Programit Kombëtar të Shkencës, duke krijuar një agjenci të pavarur për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe duke faktorizuar Këshillin Kombëtar të Shkencës si organ politikbërës i Kuvendit të Kosovës që ka për detyrë mbikëqyrjen e zbatimit të Programit. Po ashtu, do të nxitet pjesëmarrja e institucioneve kërkimore-shkencore nga Kosova në programe ndërkombëtare e në veçanti bashkëpunimi i tyre me institucione simotra nga Shqipëria dhe vendet tjera të rajonit.

Programet e doktoratës në institucionet e arsimit të lartë duhet të jenë të lidhura ngushtë me veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe, në fakt, ato duhet të operojnë vetëm në fushat ku ka një veprimtari të tillë.

Duke marrë parasysh faktin se mjetet buxhetore për PSAK dhe PKSHE nuk alokohen fare del se shpenzimet e përgjithshme për arsimin në vitin 2012 kapin shumën prej 3.86% të Bruto Produktit Kombëtar (BPK). Vendet e OECD shpenzojnë mesatarisht 4.8% të BPV-së në arsim.

Ne jemi të përkushtuar që, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, për arsim dhe shkencë të ndahet shuma prej 5% të BPK. Për ta arritur këtë duhet të rritet gradualisht shuma e mjeteve të alokuara për PSAK.